



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ____, datë __. __. 2025

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR RINOVIMIN E NDËRTHESAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 5, të ligjit nr. 37/2025 “Për performancën energjetike të ndërthesave”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Këshillit të Ministrave

VENDOSI:

- 1.Miratimin e Planit Kombëtar për Rinovimin e Ndërthesave, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- 2.Plani Kombëtar për Rinovimin e Ndërthesave rishikohet çdo 5 (pesë) vjet dhe përditësohet nëse vlerësohet e nevojshme.
- 3.Agjencia përgjegjëse për eficientë e energjisë zhvillon një proces të vazhdueshëm monitorimi në bashkëpunim me institucionet përkatëse. Monitorimi përfshin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, vlerësimin e përparimit sipas objektivave të planit, si dhe identifikimin e pengesave apo nevojave për përmirësim.
- 4.Nisur nga data 31 mars 2027, Agjencia përgjegjëse për eficientë e energjisë harton çdo vit një raport mbi zbatimin e Planit Kombëtar për Rinovimin e Ndërthesave për vitin kalendarik paraardhës. Raporti përgatitet dhe dorëzohet brenda datës 31 mars të çdo viti.
- 5.Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia për Eficientë e Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
EDI RAMA**

Zv. Kryeministër
dhe
Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Belinda Balluku